



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.959/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Saranda Bogaj - Sheremeti, kryetare e kolegjit, Franciska Zhitija Ymeri, dhe Faton Bajrami anëtar të kolegjit në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit, Tobacco Holding Group nga Prishtina, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit avokatura Sejdiu&Qerkini, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) në Prishtinë, me bazë juridike: ndëshkim tatimor, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative Divizioni Fiskal, A.nr.866/18, të datës 21.10.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 12.10.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit, Holding Group nga Prishtina, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal, A.nr. 866/18, i datës 21.10.2020, **Vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës së shkallës së parë, është refuzuar si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit, Tobacco Holding Group nga Prishtina, ndërsa është lënë në fuqi Vendimi nr.465/2017, i datës 12.01.2018, i Divizionit të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar paditësi, përmes përfaqësuesit të tij, me të cilin e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak të: vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes

faktike, dhe aplikim të gabuar i të drejtës materiale, i propozon gjykatës të anulojë Vendimin nr.465/2017 i datës 12.01.2018 i Departamentit të Ankesave i Administratës Tatimore. Duke e liruar nga qarkullimi shtesë i rezultuar me rritjen e marzhës mesatare, si dhe duke e liruar nga ngarkesa dhe pagesa e tatimit shtesë për të gjitha llojet e tatimit mbi bazën e qarkullimit shtesë.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë vlerësoi ligjshmërinë e Aktgjykimit të kontestuar si në vështrim të nenit 49 të LKA-së, nenit 81.h, të Ligjit,nr.04/L-102, për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurën nr.03/L-222, dhe nenit 194 i LPK-së, (ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA-së), në drejtim të theksimeve në ankesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se, me Vendimin e ATK–Departamenti i Ankesave, nr.465/2017, i dt.12.01.2018, është refuzuar si e pa bazuar ankesa me nr.465/2017 e datës 15.11.2017, e subjektit “Tobacco Holding Group” Sh.P.K me numër të regjistrimit të biznesit NRB 70356272 si dhe numër fiskal NRF 600192314 me drejtor z. Lirim Fezollari me seli të biznesit Magjistralka Prishtinë – Ferizaj, në mbështetje të nenit 132/2 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në lidhje me nenit 89 paragrafi 2, të Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat. Dokumenti i Vendosijes së Ndëshkimit me nr. MFA2R00000117434 në vlerë prej 1.000.00 € të datës 27.10.2017 vërtetohet si i bazuar.

I pakënaqur me vendimin e ATK-së, subjekti ushtron padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në procedurë të konfliktit administrativ. Gjykata e shkallës së parë, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor të datës 21.10.2020, dhe administrimit të provave si në procesverbalin e seancës së shqyrtimit kryesor, në prani të paditësit, përfaqësuesit të autorizuar të tij, e në mungesë të përfaqësuesit të paditurës, dhe vërtetimit të gjendjes faktike gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të organit të paditur, merr aktgjykimin e ankimuar me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar, ndërsa e lenë në fuqi vendimin e organit të paditur, sipas konkludimeve në arsyetim se; nga analiza materiale e dokumentacionit që ka paraqit paditësi, Kontrolli tatimor në Formën e vizitës përmbushëse datë 29.09.2017 në mënyrë të drejt dhe të qartë ka pasqyruar gjendjen faktike duke dhënë sqarimet se gjatë verifikimit të shitjeve dhe blerjeve të periudhës

01/2017 deri 26.09.2017 janë konstatuar dallime në deklarime për arsye se ka KMSH për këtë periudhe marzhë prej 3.13% përderisa paditësi ka deklaruar se aplikon marzhën 4.32% dhe në bazë të kësaj difference rezulton qarkullimi shtesë. Kontrolli gjithashtu ka konstatuar blerje importe në shuma më të mëdha sipas informatave doganore se sa në librin e blerjes që paditësi ka paraqit. Gjykata nga kjo formë e vizitës përmbushëse datë 29.09.2017 i ATK-së ka konstatuar se kontrolli tatimor vendimin e vet e kanë mbështetur në regjistrimet që i ka paraqit vet paditësi për vitin 2017 kështu që pretendimet e paditësit gjykata nuk ka mundur ti merr për bazë për të ndryshuar një gjendje tjetër faktike nga gjendja e konstatuar nga inspektori tatimor në momentin e kontrollit dhe gjatë procedurës administrative.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në prova dhe ligj, në tërësi e pranon edhe kolegji i kësaj gjykate. Aktgjykimi i ankimur nuk është i përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të LKA dhe të LPK siç pretendohet në ankesë dhe as me shkelje të tjera të cilat kolegji i heton sipas detyrës zyrtare si në vështrim të nenit 194 të LPK-së.

Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar drejtë ligjshmërinë e aktit përfundimtar-vendimit të atakuar nga paditësi, si në vështrim të nenit 9 dhe 44 të LKA, në të cilin aktvendim në procedurë administrative e gjithashtu sipas aktgjykimit të ankimuar me ankesë, edhe në procedurë gjyqësore në mënyrë të plotë është vërtetuar gjendja faktike e çështjes në shqyrtim, për arsye se nga provat që gjenden në lëndë gjykata nuk ka mundur të pranojë pretendimet e paditësit se kemi të bëjmë me kalkulim të gabuar të marzhës, dhe nuk mund të pranohet tani Raporti tjetër i kontrollit datë 11.09.2020 për të bërë një krahasim lidhur me gjendjen faktike të konstatuar gjatë kontrollit, pasi që kjo gjendje faktike e konstatuar nga kontrolli në Formën e vizitës përmbushëse datë 29.09.2017 është rezultat i verifikimit të regjistrave, stokut, shitblerjet nga ku ka rezultuar me pa rregullsi. Nga kjo gjendje faktike rezulton se paditësi nuk iu ka përmbajtur dispozitave ligjore nga neni 13 të Ligjit 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat dhe nenit 17 të Udhëzimit Administrativ 15/2010 për zbatimin e Ligjit 03/L-222, prandaj gjykata e konsideron si të drejtë vendimin nr.354/2017 datë 27.10.2017 nga Zgjona-ATK-së kur e paditura i ka shqiptuar paditësit ndëshkimin administrativ në bazë të nenit 53 paragrafi 2.4 të Ligjit 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat.

Nga të lartë cekurat kolegji vlerëson se Gjykata e shkallës së parë dhe organi i paditur-ATK, kanë vendosur drejtë dhe në baza ligjore kur nuk i marrin parasysh pretendimet e paditësit se pala e paditur ka bërë shkelje të dispozitave ligjore dhe atë të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative nr.05/L-031 në mënyrë të kundërligjshme ka ngarkuar tatimpaguesin me tatim shtesë, interes dhe ndëshkime, për arsye se në këtë rast paditësi ka pasur obligim që të vërtetoj faktet që e mbështesin kërkesën e tij në vështrim të nenit 81.F parag. 1 të Ligjit 04/L-102 duke mos ofruar provat materiale për të dëshmuar marzhën reale të cilën e ka aplikuar prej 3.40%.

Kolegji shqyrtoi në baza ligjore pretendimet ankimore të paditësit të cekura si më lartë si dhe të tjerat si në përshkrim të ankesës, dhe të njëjtat i refuzon si të pabazuara, dhe të pa qëndrueshme, sepse nuk mbështeten në fakte të dëshmuara, në bazë të cilave do të vërtetohej gjendje tjetër faktike e çështjes, sepse nga organi administrativ dhe gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të administruara si u cek edhe më lartë janë vërtetuar plotësisht faktet vendimtare për vendosjen në mënyrë të drejtë të kësaj çështje.

Mbi këtë gjendje të fakteve Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se, gjykata e shkallës së parë edhe organi administrativ përfundimtar ATK, drejtë kanë zbatuar dispozitat e LPK, LKA, dhe të Ligjit material për ATK-në, andaj aktgjykimi i Gjykatës së shkallës së parë vërtetohet si i drejtë, i bazuar në prova dhe ligj.

Nga të lartcekurat, e në vështrim të nenit 49 të LKA, dhe neni 200 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

K.DH.SH.II.nr.959/22, me datë 12.10.2023

**Kryetare e kolegjit,
Saranda Bogaj Sheremeti**